



Jane luajtur te shtunen kater takimet e para per javen e V ne Kategorine Superiore. Drame ne kryeqytet, feste ne Shkoder dhe triumf heroik ne Kruje. Java e V ka nisur me disa rezultate interesante. Vllaznia ka marre kryesimin e kampionatit me fitoren bindese ndaj Lacit me rezultatin 3-0. Nje gol i Hajdarit dhe dy te kroatit Bushic e kane bere Vllaznine te festoje dhe te marre lehte tre piket ndaj Lacit qe jashte fushe transformohet ne nje skuader te vogel. Ne Tirane, Partizani ka deshtuar per te marre nje fitore edhe kur ika patur mundesite ne minutene e peste shtese me nje 11 metersh te humbur nga Krasniqi. Lot ne syte e mbrojtesit kosovar qe i kishte mundesine ideale per te shenuar golin e fitores qe viente tre pike. Flamurtari ne nje dite te keqe ka menduar per mbrojtjen dhe me shume veshtiresi ja ka dale te ruaj barazimin pa gola per te marre nje pike me vlera ne transferte. Heroi i ketij takimi ishte portieri Mocka qe priti penalltine ne fund te ndeshjes per te bere te festojne pak tifozet e ardhur nga Vlora. Ne Kruje, Kukesi ka marre nje tre pikesh te arte me nje gol te shenuar pak para se te mbyllej ndeshja. Cikalleshi eshte heroi per kuksianet qe kaluan ne shtepi Kastriotin. Ne Ballsh, Bylis ka mundur lethesisht Besen me rezultatin 3-0 duke marre tre piket qe duheshin. Golat mbajne firmen e Metos, Izucukut dhe Xhejms. Te dielen luhen dy ndeshjet e fundit, Teuta-Tirana ne Kavaje dhe Skenderbeu-Lushnja ne Korce.